

LIGJ
Nr. 56/2012

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8053, DATË 21.12.1995 “PËR KALIMIN NË PRONËSI
PA SHPËRBLIM TË TOKËS BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 3/2 pika 2, fjalja e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Subjekteve të pikës 1 të këtij neni, sipërfaqja për kompensim, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 3/1 të këtij ligji, u përlllogaritet si vijon:

a) Nga totali i sipërfaqes së përlllogaritur për kompensim me truall zbritet sipërfaqja e dhënë për sheshe ndërtimi brenda kësaj zone, me vendime të miratuara nga komuna.

b) Në totalin e sipërfaqes së përlllogaritur për kompensim me truall përfshihet edhe sipërfaqja e zënë me ndërtime pa leje, që është legalizuar nga organet kompetente, sipas dispozitave të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Në rastin kur subjekti ka kryer pagesën për truallin, vlera e paguar sipas mënyrës që ajo është kryer, i kthehet këtij subjekti, brenda një viti nga data që ai merr dokumentin e pronësisë për truallin, sipas dispozitave të këtij ligji.

c) Sipërfaqet e zëna me ndërtime pa leje, të cilat janë në proces legalizimi, përfshihen brenda totalit të sipërfaqes që subjekteve u takon të marrin, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 3/1 të këtij ligji. Këto subjekte përjashtohen nga detyrimi për pagesën vetëm për sipërfaqen e truallit të zënë nga ndërtimet që do të legalizohen, sipas dispozitave të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.5.2012

Shpallur me dekretin nr. 7505, datë 5.6.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi